



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01– Nr. 400-37736/2016
Kaçanik, 25.11.2016

Në mbështetje të nenit 12.2(d) lidhur me nenet, 17, 24 dhe 40. 2 (b) të Ligjit Nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, të neni 30.1 të Ligjit Nr. 03/L- 048 - Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 6.2 lidhur me nenet, 61.1 dhe 34.5 të Statutit të Komunës, si dhe nenit 15.1(b) të Rregullores për Punë të Kuvendit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë: 25 Nëntor 2016, mori këtë:

V E N D I M
PËR RREGULLIMIN E NDARJEVE BUXHETORE TË KOMUNËS PËR VITIN 2016

1. Buxheti i Komunës do të rialokohet brenda programeve/nën programeve buxhetore për projekte kapitale deri në pesë për qind (5%) të një ndarje buxhetore në një ndarje tjetër të asaj organizate buxhetore gjatë vitit fiskal.

2. Rialokimet brenda pikës së 1. të këtij Vendimi do të reflektojnë në këto nën programe dhe për këto projekte:

2.1. Shërbimet Publike-Infrastruktura rrugore; Projektet “Ndërtimi i rrugëve në Kaçanik të Vjetër” me kod 43976 në shumë, 2,340.63 euro dhe projekti “Krijimi i hapësirave gjelbëruese dhe vendosja e shportave” me kod 43995 në shumë, 3,839.50 euro.

2.1.1.Mjetet e kursyera nga këto projekte do të shfrytëzohen për projektin “Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike” me kod 88641 të njëjti nënprogram buxhetor.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi mbi Rregullimin e Ndarjeve Buxhetore për Vitin 2016, obligohet Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.

4. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës, ndërkaq do të vlejë për deri sa nuk merret ndonjë vendim tjetër.



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01– Nr. *400-37736/16*
Kaçanik; 18.11.2016

Kryetari i Komunës së Kaçanikut, në mbështetje të nenit 24 dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Ligji nr 03/L 048) neni 30, paragrafi 30.1, Kryetari i Komunës i Propozon Kuvendit Komunal këtë:

V E N D I M

PËR RREGULLIMIN E NDARJEVE BUXHETORE TË KOMUNËS PËR VITIN 2016

I

Buxheti i Komunës do të rialokohet brenda programeve/nën programeve buxhetore për projekte kapitale deri në pesë për qind (5%) të një ndarje buxhetore në një ndarje tjetër të asaj organizate buxhetore gjatë vitit fiscal.

II

Rialokimet brenda pikës së **I-rë** të këtij vendimi do të reflektojnë në këto nën programe dhe për këto projekte:

1. Shërbimet Publike-Infrastruktura rrugore; Projektet “Ndertimi I rrugëve në Kaçanik të Vjetër” me kod 43976 në shumë prej 2,340.63 euro dhe projekti “Krijimi I hapsirave xhelbruese dhe vendosja e shportave” me kod 43995 në shumë prej 3,839.50 euro.

→ Mjetet e kursyera nga këto projekte do të shfrytëzohen për projektin “Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike” me kod 88641 të njëjtë nënprogram buxhetor.

III

Për zbatimin e këtij vendimi mbi Rregullimin e Ndarjeve Buxhetore për Vitin 2016, obligohet Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.

IV

Ky vendim i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim, ndërsa do të hynë në fuqi nga dita e aprovimit dhe do të vlejë për deri sa nuk merret ndonjë vendim tjetër.

Besim Ilazi, Kryetar i Komunës

